

# FLETA E PUNËS

# I KUJT ËSHTË FLAMURI

[KËRKO FILMIN](#)

## Punuar nga:

Merita Shala	“Mileniumi i tretë”, Prishtinë
Jeta Rexha	“Hajdar Dushi”, Gjakovë
Fatlume Hyseni	“Zenel Hajdini”, Gjilan
Driton Mallaku	“Gjon Buzuku”, Prizren

## Përshkrimi i Filmit

“Dihet se me gjenerata të tëra kanë jap jetën për flamurin kombëtar Kuq e Zi, nuk ka kuptim ta kemi këtë flamur, kur as me referendum, as me votë nuk e kemi pas të drejtën me zgjedhë”.

Filmi dokumentar “I kujt është flamuri” trajton temën e simbolit të flamurit të shtetit të ri të Kosovës dhe identitetin kosovar. Gjithashtu në këtë film bëhet gërshetimi i flamurit Kuq e Zi dhe flamurit të Kosovës që njihet si flamur me gjashtë yje, e që ngareh linja paralele në mes të këtyre dy identiteve të përkatësisë kombëtare dhe identitetit.

“Gëzuar ditëlindjen Kosovë”

## Tema Kryesore

Filmi dokumentar si një instrument për përmirësimin e procesit të mësimdhënies, si dhe zhvillimin e të menduarit kritik tek nxënësit trajton tema të ndryshme që evokojnë fenomene të ndryshme sociale.

---

## Lënda Mësimore:

### **Psikologji:**

Vetëdija dhe pavetëdija, Emocionet, Përceptimi Social (Klasa XI)

### **Sociologji:**

Shteti: Kur u krijua shteti?, Mendimi sociologjik për shtetin dhe politikën në kohën e re, Shteti dhe shoqëria, (Klasa XII)

### **Gjuhë angleze:**

People and places, Nationalities

### **Histori:**

Shpallja e pavarësisë së Kosovës (Klasa XII)

### **Edukatë qytetare:**

Kushtetuta e Kosovës (Klasa XI)

### **Filozofi:**

Shteti, e drejta dhe liria (Klasa XI)

---

## Fushat e Kurrikulës:

Gjuhët dhe Komunikimi, Shoqëria dhe Mjedis

## Përshtatshëm për:

Shkallën kurrikulare 5 dhe 6, klasa XI - XII.

Kompetencat: Kompetenca e të mësuarit, Kompetenca qytetare, Kompetenca personale, Kompetencat e komunikimit dhe të shprehurit

## Objektivat:

- Kultivimi i identitetit personal, kombëtar, përkatësia etnike
- Promovimi i vlerave të përgjithshme kulturore dhe qytetare
- Zhvillimi i përgjegjësinë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit

## Pikat e diskutimit pas shfaqjes së filmit:

- Identitet kombëtar, etniciteti, dilemat,
- Cili flamur e përfaqëson identitetin e qytetarëve të Kosovës?
- Përceptimet e qytetarëve lidhur me simbolet e Republikës së Kosovës
- Pranimi ose mohimi i simboleve- konkretisht flamurit të Kosovës nga gjeneratat e reja dhe të vjetra
- Përceptimi i simbolit të flamurit të Kosovës nga komunitetet tjera që jetojnë në Kosovë
- Dashuria për simbolet e shtetit të Kosovës, respekti, krenaria
- Lidhja emocionale me flamurin e Kosovës dhe flamurin Kuq e Zi: si një kujtim dhe marrëdhënie me kombin shqipëtar të cilit i përkasin

- Si kanë ndikuar rrethanat shoqërore në perceptimin dhe pranimin e identitetit të kosovarëve
- Pjesa përbërëse e historisë në raport me flamurin Kuq e Zi dhe flamurin e Kosovës
- Ndikimi i institucioneve e sidomos ato arsimore në arsimimin e gjeneratave dhe ngritjen e vetëdijës për simbolet shtetërore
- Sa i përfaqëson kosovarët flamuri dhe sa e paraqet thelbin e shtetit
- Tekstet shkollore në paraqitjen e historisë së Kosovës deri te shpallja e Pavarësisë dhe krijimit të simboleve shtetërore.

## Aktivitete në lidhje me filmin:

### 1. (Evokim) Stuhi mendimesh (brainstorming)

Ora e mësimit fillon diskutimin lidhur me dy çështje kryesore për debat:

<p><b>Me cilin flamur identifikoheni dhe cila është përkatësia e juaj etnike?</b></p>	<p><b>Cila është lidhja emocionale që keni në raport me këta flamuj?</b></p>
<p><b>Flamuri Kuq e Zi apo flamuri i Kosovës me yje? Kosovar apo shqipëtar?</b></p>	<p><b>Dashuri, respekt, krenari, kujtim, mohim, apati</b></p>

### 2. (Realizim) Ditari dy pjesësh

Nxënësit zgjedhin nga një paragrafë nga teksti apo shkëpusin pjesë nga filmi dokumentar, për të komentuar arsyen e zgjedhjes.

Më pas i tregohet nxënësve që fleta të ndahet në mes me një vijë vertikale kurse në anën e majtë shkruhen citatet nga teksti, kurse në të djathtë komentet.

---

### 3. (Reflektim) Rrjeti i diskutimit

Nxënësit ndahen në dy grupe (Pro dhe Kundër) dhe diskutohet çështja e pranimi apo mohimit të flamurit të Kosovës dhe identitetit Kosovar.

